

## KONTRATË PËR DHURIMIN E KUOTAVE

Sot me date 24.07.2024 palët e mëposhtme lidhin këtë Kontratë për Dhurimin e Kuotes së Kapitalit (më poshtë quajtur “Kontrata”):

1. **Z. Shani Peposhi**, shtetas shqiptar, lindur me 05.08.1950, ne Lusën, Kukës dhe banues me adresë: Rruga “Nikolla Tupe”, Kompleksi Greenpark, Tiranë.

Dhe bashkeshortja

2. **Znj. Edlira Peposhi**, shtetase shqiptare, lindur me 28.04.1956, ne Diber e Madhe, banuese me adresë: Rruga “Nikolla Tupe”, Kompleksi Greenpark, Tiranë.

**Ketu e me poshte quajtur “Pala Dhuruese”**


Dhe

3. **Znj. Gentiana Peshkatari**, shtetase shqiptare, lindur me 15.06.1982, ne Diber, banuese me adresë: Rruga “Nikolla Tupe”, Kompleksi Greenpark, Tiranë.

**Ketu e me poshte quajtur “Pala Pranuese e Dhurimit”**

### MEQËNËSE

- A. Z. Shani Peposhi, Pala Dhuruese, zoteron 1 kuote, qe perfaqeson 40% te kapitalit te shoqerise Trimed Shpk., shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, me NUIS K51612031J (“Shoqeria”), me vlere nominale 24.360.000 Leke, (“Kuota”).
- B. Znj. Gentiana Peshkatari, Pala Pranuese e Dhurimit, e bija e Pales Dhuruese, po ashtu ortake e Shoqerise qe zoteron 1 kuote qe perfaqeson 10% te kapitalit te Shoqerise.
- C. Z. Shani Peposhi, Pala Dhuruese, ka shprehur vullnetin dhe deshiren per t’ia dhuruar Kuoten Znj. Gentiana Peshkatari, Pala Pranuese e Dhurimit (“Dhurimi”).
- D. Pala Pranuese e Dhurimit ka shprehur vullnetin per te pranuar Dhurimin.
- E. Dhurimi eshte miratuar nga asambleja e ortakeve te Shoqerise e mbajtur ne date 24.07.2024.



Duke patur parasysh sa më lart palët bien dakord për sa vijon:

## **NENI 1**

### **DHURIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT**

Me nenshkrimin e kesaj Kontrate, Pala Dhuruese, Z. Shani Peposhi, i dhuron Kuoten Znj. Gentiana Peshkatari, Pala Pranuese te Dhurimit dhe Pala Pranuese e Dhurimit pranon Dhurimin e Kuotes nga Pala Dhuruese.

## **NENI 2**

### **TRANSFERIMI I TITULLIT TE PRONESISE**

- 2.1 Me nenshkrimin e kesaj Kontrate nga Palet, Znj. Gentiana Peshkatari, Pales Pranuese e Dhurimit i kalon titulli i pronesise mbi Kuoten, pa kushte apo kufizime.
- 2.2 Znj. Gentiana Peshkatari, Pale Pranuese e Dhurimit, e cila eshte ortake e Shoqerise duke zoteruar 10% te kapitalit te saj, me nenshkrimin e kesaj Kontrate nga Palet dhe kalimin e titullit te pronesise mbi Kuoten, behet pronare dhe zoteruese e 50% te kapitalit te Shoqerise, me te drejta pronesie te plota.
- 2.3 Si pasoje e transferimit te titullit te pronesise nga Pala Dhuruese tek Znj. Gentiana Peshkatari, Pala Pranuese e Dhurimit, kapitali i Shoqerise do te zoterohet nga ortaket:
  - Z. Endrit Hido, zoterues i 1 kuote qe perfaqeson 50% te kapitalit te Shoqerise
  - Znj. Gentiana Peshkatari, zoteruese e 1 kuote qe perfaqeson 50% te kapitalit te Shoqerise

## **NENI 3**

### **DEKLARIME DHE GARANCI**

- 3.1 Pala Dhuruese deklaron dhe garanton se kjo Kontratë përbën detyrim ligjor, të vlefshëm, të detyrueshëm dhe të pashmangshëm për Palen Dhuruese.
- 3.2 Pala Pranuese e Dhurimit deklaron dhe garanton se: (i) merr përsipër të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kjo marrëveshje; (ii) merr përsipër të gjitha detyrimet që rrjedhin nga qenia ortak i Shoqërisë në masën 50% të kapitalit të saj; (iii) Pala Pranuese e Dhurimit është në dijeni të plotë mbi gjendjen ekonomike dhe financiare të Shoqërisë dhe pranon Kuoten e Pales Dhuruese ashtu siç është dhe pa asnjë pretendim tjetër në lidhje me të se bashku me çdo detyrim që Shoqëria ka marrë si entitet juridik.

#### NENI 4

##### TË NDRYSHME

4.1 Kjo përbën të gjithë marrëveshjen e arritur midis palëve, premtimet, deklaratimet, garancitë në lidhje me objektin e kësaj Kontrate. Ajo mbizoteron mbi cdo marrëveshje apo angazhim tjetër të Paleve me të njëjtin objekt. Asnjë ndryshim i kësaj Kontrate nuk do të jetë i vlefshëm nëse nuk bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga vete palët në këtë Kontratë.

4.2 Kjo Kontratë do të jetë detyruese për Palët dhe pasardhësit e tyre të deleguarve të caktuar.

#### NENI 5

##### LIGJI ZBATUES, ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE DHE TE NDRYSHME

- 5.1 Për çështjet të cilat nuk janë parashikuar në këtë Kontratë apo që mund të rrjedhin prej saj do të zbatohet legjislacioni përkatës në fuqi në Republikën e Shqipërisë i cili është ligji i zbatueshëm për këtë Kontratë.
- 5.2 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve të kësaj Kontrate në lidhje me zbatimin apo interpretimin e kësaj Kontrate, nëse nuk zgjidhet me mirëkuptim mes vetë palëve, do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit gjyqësor Tiranë, vendimet e së cilës janë të ankimueshme sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.
- 5.3 Në rast se ndonjë nen i kësaj Kontrate është i pavlefshëm, i paligjshëm ose i pazbatueshëm, atëherë ky nen do të veçohet; pavarësisht nga kjo, të gjitha nenet e tjera të kësaj Kontrate do të mbeten në fuqi dhe të vlefshme. Asnjë nen i kësaj Kontrate nuk do të varet nga nene të tjera, përderisa nuk është shprehur ndryshe në Kontratë.


Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj. Kontrata është hartuar dhe do të interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar, në 4 (katër) kopje të njëjta, secila kopje në 3 (tre) flete në gjuhën shqipe.

#### PALET KONTRAKTORE


##### PALA DHURUESE

  
Z. Shani Peposhi

Bashkshortja:

  
Znj. Edlira Peposhi

##### PALA PRANUESE E DHURIMIT

  
Znj. Gentiana Peshkatari